

## **CARMEN GJANI**

Mban pozicionin e Këshilltares për media në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe është pjesë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit. Ajo është me origjinë rumune dhe me nënshtetësi shqiptare, e diplomuar me titull master shkencor, në Fakultetin e Filologjisë në Universiteti i Bukureshtit.

Ka një eksperience 15 vjeçare në fushën e medias dhe komunikimit publik dhe gjatë karrierës së saj është angazhuar në një larmi detyrash në cilësinë e ekspertit të komunikimit dhe menaxhimit të medias.

Përvoja e saj e punës fillon që në vitet e fakultetit me emërimin si gazetare në departamentin e investigimi në gazetën "Ziua" ("Dita" ) në Bukuresht, Rumani. Nga viti 2000 deri në 2002 ka ushtruar detyrën e Koordinatori për Riatdhesimin e Azilkërkuesve pranë Zyrës për Refugjatet në Ministrinë e Pushtetit Lokal në Shqipëri.

Nga viti 2002-2005, është rikthyer në Bukuresht në Ambasadën e Shqipërisë në Rumani ku shoqëroje bashkëshortin i emëruar në shërbimin diplomatik.

Në 2005, me rikthimin në Tiranë, ka ushtruar detyrën e menaxheres së marketingut në Revistën Klan , gazetën Korrieri dhe Albanian Daily News deri në vitin 2007, kur emërohet Administrator i Përgjithshëm e gazetës 'Koha Jone', detyrë që e ka mbuluar deri në vitin 2011.

Nga viti 2011-2015 është emëruar si anëtare bordi në grupin mediatik Panorama Group me detyrë përgjegjëse për projektet e zhvillimit në tregun e mediave dhe Drejtore editimi në Revistën Psikologjia, pjesë e Panorama Group.

Nga viti 2015 deri në vitin 2017 ka mbuluar detyrën e Këshilltares për media në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të Drejtores së kabinetit në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Në 2019 dhe në vijim, mban detyrën e Këshilltares për media në Këshillin e Lartë të Prokurorisë